

AKTIVITETET E PËRBASHKËTA PËR PUNËSIM TË QËNDRUESHËM

Financuar nga Bashkimi Evropian, menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë

Shkurt 2016 -
Gusht 2017

Të arriturat e projektit

Aktivitetet e Përbashkëta për Punësim të Qëndrueshëm - JASE

Projekti JASE është projekt i Programit për bashkëpunim ndër-kufitar Mal i Zi-Kosovë, i cili ka filluar në shkurt të vitit 2016 dhe përfundoi në gusht të vitit 2017. Projekti JASE është financuar nga Bashkimi Evropian dhe menaxhuar nga zyra e BE-së në Kosovë. Ky projekt është implementuar nga Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit Kosovë dhe Agjensioni i Punësimit në Mal të Zi.

Projekti ka kontribuar në **përmirësimin e bashkëpunimit në mes të zyrave të punësimit në të dyja anët e kufirit, shkëmbimin e eksperiencave dhe përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve për punësim më të mirë dhe zhvillim të burimeve njerëzore në rajonin ndër-kufitar.**



An EU funded project
Managed by the European Union
Office in Kosovo

Project JASE is implemented by:
Employment Promotion Agency Kosovo
NGO JETA Deçan



Foto e kandidatëve përfitues të granteve

50 punëkërkuës të trajnuar

Rreth 50 punëkërkuës morën pjesë në dy trajnime të organizuara në kuadër të projektit JASE. 30 prej punëkërkuësve u trajnuan për prodhimin, përpunimin dhe promovimin komercial të frutave të malit dhe bimëve mjekësore, ndërsa 20 u trajnuan dhe certifikuan për themelimit biznesi. 10 kandidatët me idetë me të mira nga trajnimi për themelimit biznesi u përkrahen me grante nga projekti JASE.

10 grante për vetëpunësim në Kosovë

Pas përfundimit të trajnimit për themelimit biznesi, 10 kandidatët me idetë me të mira janë përkrahur me grante deri në 3,000 Euro. Grantet e mundësuar nga projekti JASE janë dhënë më qëllim vetëpunësimin e kandidatëve në fushën e mbledhjes, rritjes, prodhimit të frutave të malit dhe bimëve mjekësore. Kandidatët përfitues janë nga Peja, Deçani dhe Istogu.

Kontribut në:

Eliminimin e pengesave dhe ofrimin e kushteve për punësim dhe zhvillim të burimeve njerëzore në rajonin ndër kufitar përmes prodhimit të bimëve mjekësore dhe frutave të malit.

“Unë personalisht jam e kënaqur me tërë procesin, ka qenë një përzgjedhje e denjë dhe sipas kritereve. Mund të them se është një eksperiencë jetësore, ku për mundin që kemi bërë edhe jemi shpërblyer. Ishte një motiv për të filluar dhe për të mos u ndalur asnjëherë.”

- Greta Daci

*Përfituese e grantit të projektit
JASE*



Panairi i punësimit Pejë

Panairi ndër-kufitar i produkteve bujqësore, ndërmarrësisë dhe punësimit në Kosovë është organizuar me 26 tetor 2016. Panairi ka qenë një mundësi e mirë për ndërmarrësit që të informohen rreth eksperiencave të homologëve të tyre nga Mali i Zi, me nevojat e tregut të punës dhe me të papunët. Në panair ishin prezent 30 ndërmarrës nga Kosova dhe 20 nga Mali i Zi.



Foto gjatë panairit , tetor 2016

Kontribut në:

Rritjen e fleksibilitetit të fuqisë punëtore, ofrimin e kualitetit me të mirë të jetës dhe të vendosja e një lidhje në mes të popullatës në rajonin ndër-kufitar, me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimit në të ardhmen dhe shkëmbimit të përvojave dhe të mirave.



Foto gjatë panairit , tetor 2016

Tryeza e rrumbullakët në Pejë

Gatë panairit është organizuar tryeza e rrumbullakët me temën “Përdorimi i duhur i bimëve mjekësore dhe frutave të malit përmes punësimit në rajonin ndër-kufitar”. Qëllimi i organizimit të tryezës së rrumbullakët ishte prezantimi i të rezultateve të hulumtimit, diskutimi i këtyre rezultateve dhe një prezantimi i rezultateve të projektit. Gjithashtu, gjatë tryezës së rrumbullakët u prezantuan edhe aktivitetet e ardhshme të projektit, me fokus pilot-trajnimi i të papunëve.



Foto gjatë Tryezës së Rrumbullakët, tetor 2016





Foto gjatë vizitës studimore në Zyrën e Punësimit në Pejë

Vizita studimore

Në tetor 2016 u organizuan vizita studimore në Zyrat e Punësimit në rajonin ndër-kufitar, nga ana e Kosovës.

Qëllimi i këtyre vizitave ka qenë njoftimi i këshilltarëve të punësimit në Zyrat e Punësimit të Malit të Zi me punëtorët në Zyrat e Punësimit në Kosovë, dhe prezantimi i mënyrës së funksionimit të Zyrave të Punësimit.

Punëtorja në Istog

Në qershor 2017 është organizuar punëtorja me temën “Puna me punëkërkuesit” në Istog. Punëtorja ishte një mundësi shumë e mirë për pjesëmarrësit nga Mali i Zi dhe Kosova që të shkëmbejnë përvojat e Zyrave të Punësimit në Mal të Zi dhe atyre në Kosovë, të diskutojnë planet dhe rrugët e përbashkëta për



Foto gjatë punëtorisë “Puna me punëkërkuesit”

përmirësim të shërbimeve, të diskutojnë masat e përbashkëta për punësim aktiv dhe vendosja e një rruge bashkëpunimi sistematike që bashkërisht të identifikohen dhe dizajnohen strategjitë lokale të punësimit.

Kontribut në:

Rritjen e bashkëpunimit, shkëmbimin e përvojave dhe përmirësimin e efikasitetit dhe kualitetit të Zyrave të Punësimit për ofrim sa më të mirë të shërbimeve, zhvillim të burimeve njerëzore dhe përmirësim të standardeve të jetës së popullatës në rajonin ndër-kufitar.



Aktivitetet e projektit

- ⇒ Vizita studimore në Kosovë dhe Mal të Zi;
- ⇒ Konferenca për prezantim dhe shkëmbim të përvojave;
- ⇒ Dizajnim i rekomandimeve;
- ⇒ Punëtoritë për përmirësimin e shërbimit me punëdhënësit dhe punëmarrësit;
- ⇒ Rishikimi i bashkëpunimit me institucionet vendore;
- ⇒ Zhvillimi i rekomandimeve për përmirësim të shërbimeve;
- ⇒ Hulumtimi i kërkesave të punëdhënësve në rajonin ndër-kufitar;
- ⇒ Zhvillimi i një raporti krahasues me rekomandime për të ardhmen;
- ⇒ Dy panairë ndër-kufitare (një në Kosovë dhe një në Mal të Zi);
- ⇒ Pilot trajnimi i të papunëve për prodhimin, përpunimin dhe promovimin komercial të frutave të malit dhe bimëve mjekësore;
- ⇒ Fuqizimi dhe trajnimi i të papunëve për themelimin e biznesit;
- ⇒ 10 grante për vet-punësim në fushën e grumbullimit, rritjen dhe prodhimin e bimëve mjekësore dhe frutave të malit për kandidatët nga Kosova.

Objektivi i përgjithshëm i projektit:

Përmirësimi i bashkëpunimit në mes të zyrave të punësimit në të dyja anët e kufirit, shkëmbimin e eksperiencave dhe përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve për punësim më të mirë dhe zhvillim të burimeve njerëzore në rajonin ndër-kufitar.





Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit Kosovë, Andrea Gropa
nr 40, 10000 Prishtinë, Kosovo
+381 (0)38 24 34 74 ; info@appk.org



OJQ “Jeta” , rr. Sali Cekaj Pallati i Kultures “Jusuf Gervalla”
Kati I , Deçan , Kosovo



Agjencia e Punësimit e Malit të Zi, Bulevar revolucije 5,
81000 Podgorica, MNE,
+382 20 405 237; +382 20 405 222



OJQ “Natura” - Kolašin, Montenegro Dunje Đokić nn 81210
Kolašin,
+382 (0)69 074 766, +382 (0)67 380 125

Ky buletin informativ është prodhuar me asistencën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij buletini është përgjegjësi individuale e Agjencionit të Përkrahjes së Punësimit Kosovë dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton qëndrimet e Bashkimit Evropian.

